



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 702/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Lipjan paraqitur për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Lipjan.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.11.2013, nga Lumturije Bytyqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Lipjan, në të cilën pretendohet se në vendvotimin me nr.1324e, në fshatin Resinoc, nuk janë shënuar votat e kandidatëve në FPR, dëshmitarë janë familjarët e mi të cilët më kanë votuar, andaj kërkoj që të rinumërohen votat në këto qendra votuese, thuhet në pretendimet e ankimore.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrëhet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të

kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 702/2013 më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.